



Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E hënë, 22 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 308, datë 2.2.2015	3
Vendim i Komisionit të Ankimit	3
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 1793, datë 2.6.2015	3
Vendim i Komisionit të Ankimit	3
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 2152, datë 7.7.2015	3
Vendim i Komisionit të Ankimit	3
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 2189, datë 7.7.2015	4
Vendim i Komisionit të Ankimit	4
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 895, datë 15.10.2015	4
Vendim i Komisionit të Ankimit	4
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 3379, datë 15.10.2015	4
Vendim i Komisionit të Ankimit	4
Urdhër i ministrit të Financave nr. 23, datë 11.2.2016	5
Për shpalljen e procesit të përzgjedhjes së inspektorëve financiarë publikë, ekspertë të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj.....	5
Kërkesë e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 885, datë 11.2.2016	5
Shprehje interesi për shërbim konsulence, për përditësimin e moduleve të trajnimit dhe trajnimi i administratorëve socialë mbi zbatimin e skemës së re të NE-së, ref: SAMP/CS/CQ/01-2015 ..	5



VENDIM
Nr. 308, datë 2.2.2015

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” të vendimit nr. 756, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave dhe të ankimit për vendimin përfundimtar nr. 4, datë 17.9.2014, me nr. serie 0002629 të subjektit “Xhajs Tirana” sh.p.k., protokolluar me nr. 1238, datë 23.9.2014,

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë konform me ligjit procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ absolutisht të vlefshëm parashikuar në germën “a”, të nenit 146, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Vendimi i mësipërm nr. 4, datë 17.9.2014, i dënimit me gjobë, në vlerën 1.000.000 lekë është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe mospranimin e ankimit.

KRYEINSPEKTOR
Ergys Agasi

VENDIM
Nr. 1793, datë 2.6.2015

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015 të Këshillit të Ministrave dhe të ankimit për vendimin përfundimtar nr. 11, datë 26.9.2014, i subjektit “Eurogoma Service”, protokolluar me nr. 1461, datë 15.10.2014,

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se materiali ankimor i paraqitur nuk është i plotë dhe si i tillë duhet rrëzuar.

Për vendimin e mësipërm nr. 11, datë 26.9.2014, të dënimit me gjobë në vlerën 500.000 lekë,

subjektit i lind e drejta mbas njoftimit të ankimit.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit ndaj vendimit përfundimtar.

KRYEINSPEKTOR
Ergys Agasi

VENDIM
Nr. 2152, datë 7.7.2015

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, Këshillit të Ministrave dhe i ankimit për vendimin përfundimtar nr. 8, datë 21.2.2015, i subjektit “Zyber Qenanaj”, protokolluar me nr. 653, datë 2.3.2015,

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë, duhet të lihet në fuqi, në zbatim të nenit 146 pika “a”, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Vendimi i mësipërm nr. 8, datë 21.2.2015, i dënimit me gjobë, në vlerën 30.000 lekë, është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit ndaj vendimit përfundimtar.

KRYEINSPEKTOR
Ergys Agasi

**VENDIM****Nr. 2189, datë 7.7.2015****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë, 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave dhe të ankimit për vendimin përfundimtar nr. 14, datë 1.11.2014, i subjektit “Antika”, protokolluar me nr. 1683, datë 6.11.2014,

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se materiali ankimor i paraqitur nuk është i plotë dhe si i tillë duhet rrëzuar.

Për vendimin e mësipërm nr. 14, datë 1.11.2014, të dënimit me gjobë në vlerën 30.000 lekë, subjektit i lind e drejta mbas njoftimit të ankimohet.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit ndaj vendimit përfundimtar.

KRYEINSPEKTOR
Ergys Agasi

VENDIM**Nr. 895, datë 15.10.2015****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave dhe të ankimit për vendimin përfundimtar nr. 1, datë 3.7.2015, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë, ndaj subjektit/personit/bashkimi i shoqërive “Demir Mirashi”, protokolluar me nr. 2289, datë 10.7.2015,

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë, duhet të lihet në fuqi, në zbatim të nenit 146 pika “a”, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Vendimi i mësipërm nr. 1, datë 3.7.2015, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë, ndaj subjektit/personit/bashkimi i shoqërive “Demir

Mirashi”, i dënimit me gjobë në vlerën 500.000 lekë, është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt të vlefshëm.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit

VENDOSI:

Rrëzimin e ankimit të subjektit/personit/bashkimi i shoqërive “Demir Mirashi” dhe lënien në fuqi të vendimit përfundimtar nr. 1, datë 3.7.2015, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë.

KRYEINSPEKTOR
Ergys Agasi

VENDIM**Nr. 3379, datë 15.10.2015****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave dhe të ankimit për vendimin përfundimtar nr. 2, datë 6.5.2015 të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë, ndaj subjektit/personit/bashkimi i shoqërive “Latife Veliu” sh.p.k., protokolluar nr. 1038, datë, 25.6.2015,

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë, duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 146, pika “a”, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Vendimi i mësipërm nr. 2, datë 6.6.2015, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë, ndaj subjektit/personit/bashkimi i shoqërive “Iljado Osmenaj”, i dënimit me gjobë, në vlerën 50.000 lekë, është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit

VENDOSI:

Rrëzimin e ankimit të subjektit subjektit/personit/bashkimi i shoqërive “Latife Veliu” sh.p.k. dhe lënien në fuqi të vendimit përfundimtar nr. 2, datë 6.6.2015, të ISHMP-së dega rajonale Tiranë.

KRYEINSPEKTOR
Ergys Agasi



URDHËR

Nr. 23, datë 11.2.2016

**PËR SHPALLJEN E PROCESIT TË
PËRZGJEDHJES SË INSPEKTORËVE
FINANCIARË PUBLIKË, EKSPERTË TË
JASHTËM, PUNONJËS TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE APO JASHTË
SAJ**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 112/2015, “Për inspektimin financiar publik” dhe të pikës 9, të vendimit nr. 84, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe të shpërblimit të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, të cilët do të angazhohen në kryerjen e inspektimit financiar publik”, ministri i Financave

URDHËRON:

1. Shpalljen e procesit të përzgjedhjes së inspektorëve financiarë publikë, ekspertë të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj.

2. Aplikanti për inspektor financiar publik, ekspert i jashtëm, punonjës i administratës publike apo jashtë saj, duhet të plotësojë kriteret e parashikuara në vendimin nr. 84, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe të shpërblimit të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, të cilët do të angazhohen në kryerjen e inspektimit financiar publik”.

3. Afati i aplikimit të kandidatëve për t'u përzgjedhur në listën e inspektorëve financiarë publikë është deri në datën 20 mars 2016.

4. Aplikanti do të dorëzojë në protokollin e Ministrisë së Financave nëpërmjet rrugës postare apo dorazi, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesën me shkrim;
- b) fotokopjen e kartës së identitetit;
- c) Adresën e vendbanimit, vendit të punës dhe pikave të kontaktit;
- ç) kopje të diplomës, listës së notave dhe një përmbledhje të edukimit, kualifikimeve dhe eksperiencës së punës;
- d) një fotografi të përmasave 4 x 6;
- dh) kopje të licencave dhe/ose certifikatave profesionale në fusha dhe profesione të rregulluara me ligj.

e) dëshmi dhe certifikata të trajnimeve dhe kualifikimeve pasuniversitare;

ë) vërtetim nga qendra e punës për funksionin që kryen dhe lejimin në rast angazhimi, kur aplikanti është punonjës i administratës publike;

f) numrin unik të identifikimit të lëshuar nga Qendra Kombëtare të Regjistrimit, si dhe një kopje të ekstraktit historik, në rast se aplikanti është punonjës jashtë administratës publike;

g) një dokument që vërteton se aplikanti ka plotësuar detyrimet fiskale dhe ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga administrata tatimore për tre muajt e fundit në rast se aplikanti është punonjës jashtë administratës publike;

gj) vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore në rast se aplikanti është punonjës jashtë administratës publike.

5. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, shpërndahet nëpërmjet rrugëve elektronike zyrtare dhe botohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik në Ministrinë e Financave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

KËRKESË

Nr. 885, datë 11.2.2016

PËR SHPREHJE INTERESI

SHËRBIM KONSULENCE

10 shkurt 2016

PËR PËRDITËSIMIN E MODULEVE TË
TRAJNIMIT DHE TRAJNIMI I
ADMINISTRATORËVE SOCIALE MBI
ZBATIMIN E SKEMËS SË RE TË NE-së
REF: SAMP/CS/CQ/01-2015

Shqipëri
Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale
(SAMP)

Kredia nr. 8141- AL

Numri i identifikimit të projektit ID nr. P122233



Republika e Shqipërisë, ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së *Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)*, dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbime konsulence. Shërbimi i konsulencës (Shërbimi) së kërkuar është **“Përditësimi i moduleve të trajnimit dhe trajnimi i administratorëve socialë mbi zbatimin e skemës së re të NE-së”**.

Nëpërmjet këtij shërbimi, MMSR-ja kërkon pajtimin e një firme lokale, që do të ndihmojë e do të mbështesë MMSR-në (DPSHSHI) që të përditësojë modulet e trajnimit dhe të trajnojë administratorët socialë lidhur me zbatimin e skemës e re në programin e Ndihmës Ekonomike (NE), sipas formulës së unifikuar të pikëzuar. Shërbimi i konsulencës do të zhvillohet në tri faza, duke përfshirë dhe një fazë përgatitore:

Faza përgatitore: Përditësimi i moduleve të trajnimit bazuar në ndryshimet e fundit të bëra në kuadrin ligjor në lidhje me zbatimin e fazës pilot të reformës në programin e NE-së.

Faza e parë: Ofrimi i trajnimit për rreth 549 administratorë socialë në të gjitha rajonet dhe për rreth 106 punonjës të sistemit të shërbimeve sociale në nivel lokal dhe qendror, të cilët marrin pjesë në trajnimin e zhvilluar në fazën e parë, kalojnë të gjitha modulet dhe përdorin formulën e unifikuar të pikëzuar për programin e NE-së.

Faza e dytë: Vlerësimi dhe certifikimi i 549 administratorëve socialë dhe 106 punonjësve të sistemit të shërbimeve sociale në nivel lokal dhe qendror, të cilët marrin pjesë në trajnimin e zhvilluar në fazën e parë dhe kalojnë të gjitha modulet.

Konsulencia do të përgatisë dhe të administrojë një testim të standardizuar për administratorët e trajnuar nën mbikëqyrjen MMSR-së. MMSR-ja do të shqyrtojë dhe do të miratojë testin para se konsulenti ta zhvillojë atë. Kriteret dhe kërkesat minimale për kalimin e testit do të vendosen nga MMSR-ja.

Konsulenti do të jetë një kompani lokale, e cila duhet të ketë ekspertizë në hartimin dhe dhënien e moduleve të trajnimit.

Shërbimi duhet të kryhet për 50 ditë pune. Kompania konsulente pritet të fillojë punën në mars 2016 dhe ta përfundojë atë në maj 2016.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë,

nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (EMP) fton të gjitha kompanitë lokale të konsulencës (Konsulentet), ligjërisht të pranueshme, të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimit të kërkuar.

Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet (si: broshura, përshkrimi i minimumit të tri detyrave të ngjashme të ndërmarrja nga konsulenti, eksperiencë në kushte të ngjashme, kualifikimet e përgjithshme dhe përvojën dhe numrin e stafit kyç të përshtatshëm për këtë detyrë etj.) dhe dokumentet ligjore si vijon: 1) ekstrakt historik origjinal të regjistrimit të biznesit (lëshuar nga QKR-ja) dhe numrin përkatës të identifikimit të biznesit (NIPT); 2) dokument origjinal të lëshuar nga autoriteti përkatës tatimor që të vërtetojë se biznesi nuk ka asnjë detyrim ndaj autoriteteve tatimore shqiptare dhe ka paguar të gjitha sigurimet shoqërore dhe shëndetësore sipas legjislacionit shqiptar.

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formën e një *joint venture* apo në formën e nënkontraktimit për të rritur kualifikimet e tyre.

Kriteret për shortlistimin janë:

1. Eksperienca specifike e firmës në fushën e detyrës	40 pikë
2. Numri i shërbimeve të ngjashme/kontratave të kryera gjatë tri viteve të fundit	20 pikë
3. Eksperienca e përgjithshme dhe kualifikimi i stafit kryesor	40 pikë

TOTALI

100 pikë

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore, për: *Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA & Grante nga Huamarrësit e Bankës Botërore* (Udhëzuesi i Konsulencës) - version i janarit të 2011-s.

Konsulenti do të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është “Përzgjedhje sipas Kualifikimit të Konsulentëve (CQ)”, e përcaktuar në Udhëzuesit e Bankës



Botërore, në përputhje me procedurat e udhëzuesve të Bankës Botërore për përzgjedhjen e punësimit të konsulentëve (version i janarit të 2011-s).

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00–16:00 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00 të premtën.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me *e-mail*), deri më **26 shkurt 2016**.

**Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)
Projekti i Modernizimit të Asistencës
Sociale (SAMP)**

**Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
– kati 1**

Rruga e Kavajës, nr. 53, Tirana, Albania

Në vëmendje të znj. Suzana Papadhopulli

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË**

Gjergj Teneqexhiu

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2016